

CROSS-REIS

**CROSS-disciplinary network for research excellence in Regenerative Economy Innovation eco-Systems
Funded by the European Union**

Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995, Tirana, Albania.

Tel: +355 4 240 74 23

Fax: +355 4 240 74 25

Mob: +355 (0)694050545

E-mail: co-plan@co-plan.org

CROSS-REIS INFO-Day

**CROSS-REIS organizon një tryezë të rrumbullakët me temë
'Kapërcimi i hendekut: Sfidat dhe mundësitë në avancimin e
ekonomisë qarkulluese për SME-të dhe akademinë në Shqipëri'**

Tiranë, 27 shtator 2024 – Në kuadër të Javës së Arkitekturës Tirana (TAW) 2024, CROSS-REIS organizoi një INFO-Day dhe një tryezë të rrumbullakët me titull "Kapërcimi i hendekut: Sfidat dhe mundësitë në avancimin e ekonomisë qarkulluese për SME-të dhe akademinë në Shqipëri". Eventi mbledhi së bashku ekspertë dhe palë të interesuara për të trajtuar çështje që lidhen me ekonominë rigjeneruese dhe ekonominë qarkulluese në Shqipëri.

Aktiviteti u hap me një fjalë përshëndetëse nga znj. Anila Bejko, Drejtoreshë Ekzekutive e Co-PLAN dhe u pasua nga prezantimi i projektit CROSS-REIS. Gjatë prezantimit, znj. Rea Muka prezantoi objektivin kryesor të projektit, konsorciumin, fushat kryesore të studimit dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës së parë të projektit.

Kjo hapje më pas mundësoi një diskutim interesant midis pesë panelistëve tanë dhe audiencës mbi temën kryesore të tryezës së rrumbullakët. Tryeza e rrumbullakët u moderua nga znj. Kejt Dhrami, eksperte në Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Ajo prezantoi fokusin e diskutimit, ndërthurjen e akademisë dhe sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME) në avancimin e ekonomisë qarkulluese në kontekstin shqiptar, duke hapur fjalën për perspektivat e panelistëve. Panelistët, fal eksperiencës së tyre në këtë fushë, sollën perspektivat dhe rekomandimet e tyre mbi tematikën e ekonomisë qarkulluese në sektorin e akademisë dhe SME-ve.

Gjatë tryezës, znj. Valbona Koçi nga EU4Innovation, diskutoi sesi ky programi po përmirëson aksesin në inovacion dhe financim për institucionet akademike dhe kërkimore në Shqipëri. Ajo vuri në dukje se ndërkohë që ekosistemi fillestar është premtues, ka ende një hendek midis këtyre nismave dhe kapaciteteve kërkimore dhe zhvilluese të universiteteve. Duke theksuar qasjen e heliksit të katërfishtë - e cila nxit bashkëpunimin midis akademisë, industrisë, qeverisë dhe shoqërisë civile - znj. Koçi shpjegoi se si ajo nxit inovacionin dhe qëndrueshmërinë, veçanërisht në ekonominë qarkulluese. Ajo përmendi gjithashtu mundësitë kryesore për universitetet dhe bizneset përmes skemave të ndërtimit të kapaciteteve dhe financimit të EU4Innovation.

Znj. Marsela Robo, Drejtoreshë në AKKSHI, diskutoi mbi sfidat e krijimit të lidhjeve efektive midis institucioneve kërkimore dhe sektorit privat në Shqipëri, veçanërisht në kontekstin e ekonomisë qarkulluese. Ajo theksoi çështje të tilla si bashkëpunimi i kufizuar dhe burimet e pamjaftueshme, të cilat pengojnë përparimin në këtë fushë. Znj. Robo theksoi gjithashtu rolin e AKKSHI-t në promovimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit, i cili mbështet projektet që lidhen me çështjet mjedisore, duke përfshirë iniciativat e ekonomisë qarkulluese, me qëllim rritjen e kërkimit dhe nxitjen e praktikave të qëndrueshme.

Znj. Jona Haxhiali, Këshilltare për Ekonominë Qarkulluese dhe Angazhimin e Sektorit Privat në Ekonominë Qarkulluese në EU 4 Circular Economy and Livable Cities, diskutoi mbi sfidat me të cilat përballen SME-të në fazat e hershme të adoptimit të praktikave të ekonomisë qarkulluese në Shqipëri. Ajo shtjelloi sfidat si burimet e kufizuara, ndërgjegjësimin e ulët dhe pengesat rregullatore, por përmendi edhe modelet e suksesshme ku bizneset kanë filluar të integrojnë praktika të ekonomisë qarkulluese. Znj. Haxhiali shpjegoi se si projekti CCL po bashkëpunon aktivisht me bizneset dhe institucionet akademike shqiptare për të promovuar kërkimin dhe inovacionin në këtë fushë. Ajo ndau gjithashtu njohuri mbi nismat Circular City Labs në Tiranë dhe Shkodër, të cilat synojnë të krijojnë zgjidhje të qëndrueshme urbane dhe tashmë kanë arritur rezultate premtuese në promovimin e praktikave të ekonomisë qarkulluese.

Z. Edvin Zhllima, ekspert në DSA dhe profesor në Universitetin Bujqësor të Tiranës (UBT), theksoi mundësitë kryesore për zbatimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese në sektorin bujqësor të Shqipërisë. Ai vuri në dukje se përmirësimi i aksesit në informacion dhe njohurive financiare është thelbësor për t'u mundësuar fermerëve dhe SME-ve të adoptojnë praktika inovatore dhe të qëndrueshme. Z. Zhllima diskutoi gjithashtu progresin e Shqipërisë drejt përafrimit me politikat bujqësore të BE-së, duke vënë në dukje se ndërkohë që po bëhen përparime, ka ende një hendek në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Ai theksoi bashkëpunimin e Universitetit të Bujqësorë të Tiranës me sektorin privat, veçanërisht SME-të në agrobiznes, duke ndarë projekte të suksesshme që kanë nxitur inovacionin dhe zgjidhjet e integruara të ekonomisë qarkulluese.

Znj. Merita Toska, zv.rektore në Universitetin Polis, diskutoi mbi sfidat dhe arritjet e ekonomisë qarkulluese në Shqipëri në krahasim me vende të tjera të Ballkanit Perëndimor. Ajo theksoi nevojën për të integruar konceptet e ekonomisë qarkulluese në kurrikulat akademike, të tilla si programi master në mjedis dhe planifikim, dhe ndau përvoja të suksesshme si projekti W2E dhe iniciativa GreenFORCE e Malit të Zi. Megjithatë, ajo vuri në dukje se pavarësisht progresit, bizneset në Shqipëri mbeten kryesisht të papërgatitura për adoptimin e këtyre praktikave. Znj. Toska theksoi gjithashtu qasjen bashkëpunuese të Universitetit Polis me bizneset dhe OSHC-të për të mbështetur inovacionin, por vuri në dukje se shumë sfida mbeten në nxitjen e këtij bashkëpunimi. Lidhur me projektin Circular City Labs Tirana, ajo diskutoi rezultatet e pritshme, duke përfshirë promovimin e praktikave të qëndrueshme urbane, por duke pasur parasysh sfidat e zbatimit që lidhen me burimet e kufizuara dhe angazhimin e palëve të interesuara.

Pas diskutimit në tryezën e rumbullakët, znj. Fiona Imami bëri një prezantim të shkurtër të aktiviteteve të ardhshme në kuadër të projektit CROSS-REIS. Ajo theksoi

oportunitetet për trajnime, evente dhe aktivitete që targetojnë përfshirjen e aktorëve të ndryshëm.

CROSS-REIS, një projekt që financohet nga EU Horizon, i kushtohet nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet organizatave të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në tetë vende: Serbi, Mali i Zi, Shqipëri, Kroaci, Slloveni, Spanjë, Norvegji dhe Itali, për të mbështetur tranzicionin drejt paradigmës së ekonomisë rigjeneruese. Nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve, strategjive të kërkimit dhe zhvillimit, bashkëpunimit dhe rrjetëzimit, bazave të të dhënave dhe instrumenteve të ndryshme, projekti synon të nxisë ekselencën në kërkimin shkencor në nivel institucional. Aktiviteti kërkimor i CROSS-REIS fokusohet në tre sektorë kryesor të ekonomisë rigjeneruese, të cilët janë biodiversiteti urban, ekonomia qarkulluese dhe menaxhimi i mbetjeve.

Për më shumë informacion në lidhje me CROSS-REIS dhe kërkimin e tij, ju lutemi kontaktoni:

CROSS-REIS

Email: info@crossreis.com

Faqja zyrtare: <https://crossreis.com/>